



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË SOCIALISTE

Nr. 2780 prot.

Tiranë, më 15.07, 2019

Lënda: Propozim për shkarkimin e zotit Arben Malaj si anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

Drejtuar: Z. Gramoz RUÇI

Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë

Baza ligjore: Ligji nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë";
Manuali i Monitorimit Vjetor dhe Periodik, miratuar me Vendimin e Kuvendit nr. 134/2018.
Rregullorja e Kuvendit

I nderuar Z.Kryetar,

Si çështje e evidentuar gjatë monitorimit të vazhdueshëm të institucionit edhe gjatë procedurave të raportimit në Kuvend të Bankës së Shqipërisë, Shërbimi i Monitorimit i ka përcjellë Kryetarit të Kuvendit shqetësimin për rastet e daljeve publike të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës së Bankës së Shqipërisë.

1. Dispozitat e rregullores së Kuvendit:

- a) Neni 114 i Rregullores parashikon shkarkimin e anëtarëve të organeve Kushtetuese;
- b) Neni 115 i Rregullores parashikon shkarkimin e anëtarëve të organeve të krijuara me ligj;

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, citohet në nenin 161 (pika2) të Kushtetutës por në të përcaktohet vetëm mandati i Guvernatorit, ndërsa për anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë procedura e zgjedhjes dhe mandati, përcaktohet në ligjin e Bankës së Shqipërisë.

- a) Si anëtar i një organi Kushtetues (këshilli mbikëqyrës i parashikuar në nenin 161/pika2), procedura e propozimit kërkon nënshkrimin dhe propozimin nga 28 deputetë. Sipas këtij opsioni kompetenca për shqyrtimin e parë të propozimit i takon Komisionit të Ligjeve dhe procedura është ajo e përcaktuar edhe për presidentin e Republikës;
- b) Si anëtar i një organi të rregulluar me ligj të veçantë, kërkesa i drejtohet Kryetarit të Kuvendit dhe shqyrtimi i kalon Komisionit të përhershëm përkatës, në këtë rast Komisionit për Ekonominë dhe Financat.

2. Rregullimi i parashikuar nga Vendimi i Kuvendit nr.134/2018.

Kuvendi i Shqipërisë me vendimin nr. 134/2018 të datës 20.12.2018 ka miratuar manualin e monitorimit vjetor dhe periodik pjesë e të cilit janë rregullat për sjelljen publike të personave të emëruara nga Kuvendi.

Manuali i Monitorimit Vjetor dhe Periodik të Institucioneve, midis të tjerave parashikon:

"Institucionet në monitorim, që nuk janë pjesë e sistemit të drejtësisë, miratojnë Kodin Etik dhe Rregullat e Sjelljes, të cilat duhet të mbajnë në konsideratë dhe të rregullojnë midis të tjerave etikën e funksionarit publik të emëruar nga Kuvendi dhe normat e përfaqësimit të institucionit prej tyre tek të tretët dhe ndaj publikut. Për çdo individ që merr një emërim nga Kuvendi, duhet të jetë e qartë, që me vullnet të lirë po merr përsipër një funksion publik. Ndaj pas kësaj, e gjithë sjellja dhe veprimtaria e tij duhet të ridimensionohet, duke u përshtatur me funksionin publik dhe me qëllim që të sigurohet dhe të mos çënohet paanësia në ushtrimin e funksionit individual nga njëra anë dhe funksionit të institucionit nga ana tjetër.

Në analizë të këtyre normave sjelljeje, gjatë vitit 2018 dhe në vazhdim Zoti Arben Malaj, i emëruar nga Kuvendi si anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, ka pasur si sjellje konstante dalje publike dhe deklamim të qëndrimeve personale, edhe të natyrës politike, të palidhura me politika mbikëqyrje të Bankës së Shqipërisë dhe që nuk gjejnë asnjë referim në çështje të diskutuara në veprimtari të Këshillit Mbikëqyrës së Bankës së Shqipërisë, apo që të mund të klasifikohen si veprimtari në shërbim të edukimit të publikut, mbi tregun bankar.

3. Rregullimi i parashikuar nga Kodi Etik i Këshillit Mbikëqyrës të BSH i vitit 2003.

Në referim të rastit, duhet t'ju sqarojmë edhe se Këshilli Mbikëqyrës i BSH ka miratuar Rregulla të posaçme për sjelljen publike të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të BSH.

Rregullimi i sjelljes publike të anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë është trajtuar denjësisht në "Kodin e Etikës", të miratuar nga ky Këshill që në vitin 2003.

Si pjesë e atyre rregullave parashikohet që:

Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës duhet të marrin parasysh karakterin publik të funksionit të tyre dhe të sillen në mënyrë të tillë që të ruajnë dhe të asistojnë besimin në publik lidhur me ta. Ata duhet të jenë të ndërgjegjshëm për rëndësinë e detyrave dhe të përgjegjësi të tyre, pasi përfaqësojnë organin më të lartë vendimmarrës dhe mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës duhet të veprojnë në interesin më të mirë të përgjithshëm të Bankës së Shqipërisë, si dhe të gjithë sistemit bankar në Shqipëri.

Në përputhje me ligjin "Për Bankën e Shqipërisë" anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës kur ushtrojnë pushtetet dhe kryejnë detyrat që u janë ngarkuar, nuk duhet të kërkojnë ose të marrin udhëzime nga institucione apo nga organizma të tjerë jashtë Bankës së Shqipërisë. Ata, gjithashtu, nuk duhet të ndikohen nga çdo subjekt tjetër që kërkon të influencojë tek ata për të ndërhyrë në veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë.

Çdo veprimtari tjetër e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës, e cila kryhet jashtë detyrave të tij të përcaktuara në ligjin "Për Bankën e Shqipërisë" nuk duhet të ketë ndikim negativ mbi detyrimet që at ka ndaj Bankës së Shqipërisë dhe nuk duhet të dëmtojë imazhin e saj. Në artikujt shkencorë ose akademikë, anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës duhet të qartësojnë se artikulli është hartuar personalisht dhe nuk përfaqëson qëndrimin zyrtar të Këshillit Mbikëqyrës apo të Bankës së Shqipërisë.

Marrëdhëniet e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës me grupe që përfaqësojnë interesa të tjerë, nuk duhet të bien ndesh me pavarësinë dhe me integritetin që kërkon pozicioni i tyre në Bankën e Shqipërisë."

Siç mund të konstatohet, parashikimet e Kodit Etik të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë janë në të njëjtën linjë arsyetimi dhe rregullimi me sa kërkohet edhe nga Manuali i Monitorimit Vjetor dhe Periodik i miratuar me Vendim të Kuvendit.

4. Kërkesa për Këshillin Mbikëqyrës të BSH e miratuar me Rezolutën e Kuvendit të datës 08.05.2019.

Në vijim të trajtimit të këtij shqetësimi, Kuvendi në Rezolutën "Për vlerësimin e veprimtarisë së Bankës së Shqipërisë për vitin 2018", midis të tjerave ka kërkuar që:

"Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë të marrë në shqyrtim zbatimin e Kodit të Etikës nga anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, për të standardizuar rregullat e sjelljes dhe përfaqësimit publik të institucionit, në përputhje edhe me dispozitat e miratuara nga Kuvendi në lidhje me Manualin e Monitorimit Vjetor dhe Periodik, për pjesën që i takon kësaj çështje".

Në vlerësim të sjelljes në raport me publikun, mund të konkludohet se z. Arben Malaj në cilësinë e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës, në asnjë nga daljet publike nuk ka trajtuar çështje që mund t'i shërbejnë publikut për edukimin e tij ose për informimin e publikut për veprimtari të Këshillit Mbikëqyrës në kufijtë e lejuar nga legjislacioni i fushës.

Temat e trajtuara prej tij në daljet publike, janë të një natyre thellësisht politike, të ndryshme nga politikat e rregulluara dhe mbikëqyrura nga Banka e Shqipërisë; në kundërshtim të hapur me fushën e kompetencave të ushtruara si anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, kompetencat e të cilit parashikohen në Nenin 43 i Ligjit "Për bankën e Shqipërisë".

5. Analiza e dispozitave ligjore për marrjen e masave institucionale ndaj rastit

Në analizë të dispozitave të Ligjit "Për Bankën e Shqipërisë" dhe të akteve të miratuara nga Kuvendi mund të arsyetojmë:

Z. Arben Malaj është një nga anëtarët e emëruar në këtë post me Vendim të Kuvendit në mbështetje të nenin 44 të Ligjit organik të Bankës së Shqipërisë.

Neni 47 i Ligjit parashikon se:

2. Guvernatori dhe zëvendësguvernatorët e Bankës së Shqipërisë, si dhe çdo anëtar tjetër i Këshillit Mbikëqyrës, mund të shkarkohen nga Kuvendi me propozim të shumicës së anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, kur:

c) personi i propozuar për shkarkim gjatë ushtrimit të detyrës ka shkelur rëndë etikën e punës dhe ka cenuar thellë interesat e Bankës së Shqipërisë.

Duke konsideruar këtë dispozitë, dhe Rezolutën e miratuar për vlerësimin e veprimtarisë për vitin 2018, duhet vlerësuar që Kuvendi në rezolutë i ka kërkuar Këshillit Mbikëqyrës dhe si rrjedhim anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të BSH që të analizojnë aktet e miratuara nga vetë Këshilli Mbikëqyrës dhe të shprehën në lidhje me vendimmarrjen në këshill ose individualisht.

Rezulton se pas më shumë se dy muajsh, nuk ka asnjë reagim dhe as ndonjë procedurë të nisur për shqyrtimin e pikës së rezolutës që kërkonte reagim institucional apo individual as nga Këshilli Mbikëqyrës, as nga anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës.

Sa më sipër:

- mund të vlerësohet se Këshilli Mbikëqyrës dhe anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, refuzojnë pa asnjë justifikim ligjor të shqyrtojnë ose të reagojnë ndaj sjelljes jo etike dhe në kundërshtim të hapur me rregullat e Kodit të sjelljes të Miratuar nga vetë Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë;
- sjellja e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë dhe e të gjithë anëtarëve të Këshillit, është refuzim i hapur i respektimit dhe zbatimit të ligjit mbi të cilin ata duhet të udhëhiqen dhe tentative për pengimin e Kuvendit për të zbatuar ligjin në një rast evident të shkeljes së tij ndaj për këto arsye,
- Kuvendi i Shqipërisë ka detyrimin të ndërmarrë kryesisht nismën për analizën e rastit dhe propozimin e masave përkatëse. Ndërmarrja e kësaj nisme kryesisht kryhet në zbatim të dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, nr. 44/2015.
 - 1- Vendimmarrja e Kuvendit në këtë rast nuk prek parimin e ligjshmërisë (neni 107 KPrA), për sa kohë që në çdo rast vendimmarrja e parashikuar nga neni 43 i Ligjit "Për Bankën e Shqipërisë", i takon Kuvendit;
 - 2- Kodi i Procedurave Administrative (neni 70), për analogji, në raste të përsëritjes së vendimmarrjes së përbashkët të organeve publike, ka parashikuar rastin e nxjerrjes së vendimit nga organi publik pa pritur përgjigjen apo reagimin e një organi tjetër i cili parashikohet nga ligji që duhet të japë pëlqimin, konfirmimin, miratimin, mendimin (apo "propozimin" paraprak në rastin tonë), kur organi tjetër nuk përgjigjet brenda një afati prej 30 ditësh, (që prej datës kur është miratuar rezoluta e Kuvendit kanë kaluar më shumë se 60 ditë);

- 3- Kuvendi i Shqipërisë mund ta arsyetojë iniciimin e procedurave të shqyrtimit dhe propozimit të masave përkatëse, në lidhje me rastin, në kushte të ushtrimit të kompetencave të veta diskrecionale (neni 11 KPrA), sa kohë që:
- Vendimmarrja për rastin i takon sidoqoftë Kuvendit;
 - Vendimmarrja në çdo rast nuk tejkalon kufijtë e ligjit, megjithëse në çdo rast duhet të kujtojmë që Kuvendi i Shqipërisë nuk është një organ i zakonshme administrativ, por organi i vetëm ligjvënës;
 - Zgjedhja e bërë ka qenë e detyruar nga rrethanat me të cilat është përballur Kuvendi si pasojë e sjelljes së anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, që kanë zgjedhur të vendosim marrëdhëniet shoqërore, mbi detyrat funksionale dhe angazhimet ligjore.














6. Vlerësimi i sjelljes publike të zotit Arben MALAJ

Nëse analizon secilën prej daljeve publike të Zotit Arben Malaj dhe të gjitha ato të marra së bashku mund të arrihet në konkluzionin se:

- Në asnjërin prej rasteve të daljeve publike të anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës, ato dalje nuk i kanë shërbyer të interesit më të mirë të përgjithshëm të Bankës së Shqipërisë, si dhe të gjithë sistemit bankar në Shqipëri;
- Në asnjërin prej rasteve të daljeve publike të anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës nuk është marrë parasysh karakteri publik i funksionit që ushtron si anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të BSH dhe kjo natyrë sjellje nuk ka qenë dhe nuk i ka shërbyer aspak ruajtjes dhe nxitjes së besimit në publik lidhur me institucionin e Bankës së Shqipërisë;
- Në asnjërin prej rasteve të daljeve publike të anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës nuk reflektohet përgjegjësi institucionale në raport me temat e trajtuara dhe qëndrimet publike të mbajtura për to dhe nuk referohet aspak nivelit i nevojshëm i ndërgjegjshëm për rëndësinë e detyrave dhe të përgjegjësive, si përfaqësues i organit më të lartë vendimmarrës dhe mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë;
- Secila prej daljeve publike të anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës dhe të gjitha rastet së bashku mund të çojnë në konkluzionin që temat e trajtuara dhe qëndrimet e shprehura mund ketë ndikim negativ mbi detyrimet që ai ka ndaj Bankës së Shqipërisë dhe duke qenë se ato shprehin qëndrime dhe vlerësime që janë pjesë e analizave politike të lidhura me grupime politike, besojmë se ato dëmtojnë edhe imazhin e Bankës së Shqipërisë;
- Secila prej daljeve publike të anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës dhe të gjitha rastet së bashku mund të çojnë në konkluzionin që temat e trajtuara dhe qëndrimet e shprehura bien ndesh dhe cenojnë pavarësinë dhe integritetin që kërkon pozicioni i mbajtur në Bankën e Shqipërisë.”;

GRUPI I DEPUTETËVE PROPOZUES:

1. Taulant Balla
2. Ervin Basha
3. Dragan Kojic
- ~~4. Arben Ahmeti~~
5. Spahë Pasha
6. Adem Hoxhaj
7. Jergis Gylybi
8. Florenc Spaho
9. Dritan Bëri
10. Blas Mbrokull
11. Adem Risto
12. BURRË GJERA
13. Almira Xhembullë

14. Fadil Nasri 
15. Jamet Bagiraj 
16. Ilirien Gendhermy 
17. Arben Konomri 
18. Robert Shkilloz 
19. Edlira Bode
20. Andreas Jaku 
21. SADI VORPSI 
22. Eljo Hyska 
23. Shkëlze Bushlae 
24. Antoneta Shinga 
25. Enomela Valitij 
26. Juan Hureska 
27. Klarena Spaher 
28. ULBI MANJA 